



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

**Raporti i Akreditimit Institucional
të Universitetit të Tiranës**

Tetor 2018

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Z. Grant Horsburgh Kryetar



2. Z. Kevin Kendall Anëtar

Kevin Kendall

3. Prof. As. Ana Kapaj Mane Anëtare



Përmbajtja

Tabela e përmbajtjes

Rreth këtij vlerësimi	5
Konteksti i këtij vlerësimi.....	5
Raporti i përmbledhur.....	7
Përmbledhje e Gjetjeve.....	10
Praktika e mirë	10
Pikat e dobëta.....	10
Rekomandimet	11
Pohime mbi veprimet e ndërmarra.....	11
Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi.....	11
Gjykim i përmbledhur	12
Raporti i detajuar	13
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	13
Praktika e mirë	16
Pikat e dobëta.....	16
Rekomandimet	16
Pohim për veprimet e ndërmarra	17
Gjykim	17
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet.....	17
Gjetjet.....	20
Praktika e mirë	20
Pikat e dobëta.....	21
Rekomandimet	21
Pohim për veprimet e ndërmarra	21
Gjykim	21
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula.....	22
Gjetjet.....	25
Praktika e mirë	25
Pikat e dobëta.....	25
Rekomandimet	25
Pohim për veprimet e ndërmarra	25
Gjykimi	26
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi	27
Gjetjet.....	29
Praktika e mirë	30
Pikat e dobëta.....	30
Rekomandime	30
Pohim për veprimet e ndërmarra	30
Gjykimi	30
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	31
Gjetjet.....	33
Praktika e mirë	33
Pikat e dobëta.....	33
Rekomandime	33
Pohimi për veprimet e ndërmarra	34
Gjykimi	34
Përmbledhje e gjetjeve	34
Praktika e mirë	34
Pikat e dobëta.....	34
Rekomandimet	34

Pohim për veprimet e ndërmarra	35
Përmbledhje e gjykimeve për secilën Fushë të Vlerësimit.....	35
Gjykim i përmbledhur	35
Lista e evidencave	36

Rreth këtij vlerësimi

Synimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se sa i përmbush çdo IAL Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është një proces i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që janë të specializuar në të njëjtën fushë, dhe çdo grup vlerësimi përbëhet nga një ndërthurje e vlerësuesve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA dhe të vlerësuesve shqiptarë të caktuar nga APAAL. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një vlerësues i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'i ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë përparësitë për përmirësime (procesit që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe të mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë përmbledhur nën pesë tematika me këto Fushat Vlerësimi: Organizimi dhe Drejtimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, të Nxëniet, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet mbi veprimet ndërmarra dhe pikat e dobëta për çdo Fushë Vlerësimi, ndjekur nga një gjykim lidhur me shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të. Gjykimet që mund të bëjnë vlerësuesit janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur në mënyrë të konsiderueshme; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në përfundim, vlerësuesit e përmyllin punën e tyre me rekomandimin e një gjykimi përmbledhës, që i dorëzohet Këshillit të Akreditimit të APAAL. Ky gjykim i përgjithshëm jepet sipas shkallës së mëposhtme të vlerësimit me katër nivele:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përpilimit të raportit, QAA ka siguruar ekspertë mbështetës për grupin e vlerësimit duke siguruar që grupi t'i mbështesë Gjetje në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Tiranës u themelua në vitin 1957 me emrin Universiteti Shtetëror i Tiranës, për të përmbushur nevojat në rritje të vendit për specialistë të kualifikuar. Institucioni fillestar përbëhej nga gjashtë fakultete, që ishin ngritur mbi institucionet ekzistuese

(Instituti i Lartë Pedagogjik; Instituti i Shkencës; Instituti Politeknik; Instituti i Mjekësisë, Instituti i Bujqësisë; dhe, Instituti i Ekonomisë dhe Drejtësisë). Në vitin e tij të parë akademik, numri i studentëve ishte 3,613 dhe degët ishin të ndara në pesëmbëdhjetë specialitete.

Në vitin 1967 përfundoi ndërtimi i kampusit të parë të përmasave të mëdha të institucionit. Në vitin 1977, numri i studentëve me kohë të plotë arriti shifrën 8,880, përafërsisht 50 për qind prej të cilëve ishin femra. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe u diplomuan 21,368 studentë, duke kontribuar në të gjitha fushat e jetës në vend. Në vitin 1991, fakultetet e inxhinierisë së universitetit u zëvendësuan nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe në vitin 2013 Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike u zëvendësuan nga Universiteti i Mjekësisë. Në vitin 1997, Universiteti mori mirënjohjen e Presidentit të Republikës për kontributin e jashtëzakonshëm në zhvillimin e fushës shkencore, arsimore, kulturore dhe ekonomike në Shqipëri. Aktualisht, universiteti është zgjedhja e parë e shumicës së nxënësve të shkollës së mesme dhe atyre nga trojet e tjera shqipfolëse, jashtë kufijve kombëtarë.

Deri në momentin e këtij vlerësimi institucional, ai është universiteti më i madh publik në Shqipëri, që përbëhet nga tetë njësi kryesore, nga të cilat gjashtë janë fakultete dhe dy institute të kërkimit shkencor (Fakulteti i Shkencave Natyrore; Fakulteti i Gjuhëve të Huaja; Fakulteti i Drejtësisë; Fakulteti i Shkencave Sociale; Instituti i Studimeve Evropiane; Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë; Fakulteti i Ekonomisë; Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar), katër qendra kërkimore (Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës Shqiptare; Departamenti i Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Rrjetit Monitorues; Departamenti i Radiometrisë dhe Radiokimisë; Departamenti i Metodave Analitike Instrumentale) dhe 38 departamente administrative. Universiteti ofron programet e mëposhtme: 36 programe të ciklit të parë; 36 Mastera Profesionalë; 65 Mastera të Shkencave, dhe 38 programe doktorature. **[Informacion mbi IAL-të në faqen e ASCAL]** Aktualisht në niversitet janë të punësuar 779 punonjës të stafit akademik të brendshëm dhe studiojnë 23,551 studentë.

Raporti i përmbledhur

Universiteti i Tiranës (universiteti) është universiteti më i madh publik në Shqipëri, që përbëhet nga tetë njësi kryesore, nga të cilat gjashtë janë fakultete dhe dy institute të kërkimit shkencor (Fakulteti i Shkencave Natyrore; Fakulteti i Gjuhëve të Huaja; Fakulteti i Drejtësisë; Fakulteti i Shkencave Sociale; Instituti i Studimeve Evropiane; Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë; Fakulteti i Ekonomisë; Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar), katër qendra kërkimore (Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës Shqiptare; Departamenti i Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Rrjetit Monitorues; Departamenti i Radiometrisë dhe Radiokimisë; Departamenti i Metodave Analitike Instrumentale) dhe 38 departamente administrative. Universiteti ofron programet e mëposhtme: 36 programe të ciklit të parë; 36 Mastera Profesionalë; 65 Mastera të Shkencave, dhe 38 programe doktorature. Aktualisht në Universitet janë të punësuar 779 punonjës të stafit akademik të brendshëm dhe studiojnë 23,551 studentë.

Ky është Vlerësimi i dytë Institucional për universitetin, për të vlerësuar se deri në çfarë shkalle janë përmbushur Standardet Shtetërore të Cilësisë, që hynë në fuqi në vitin 2011. Raporti i vlerësimit të parë të jashtëm në muajin prill të vitit 2017 nuk përfshiu asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, dha 16 rekomandime që universiteti të merrte parasysh trajtimin e fushave të identifikuar të pikave të dobëta dhe pohoi për një veprim në proces e sipër. Në raport u shënuan gjykimet e mëposhtme për secilën zonë Vlerësimi:

- Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbushur pjesërisht**.
- Standardet për Burimet janë **përmbushur kryesisht**.
- Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur kryesisht**.
- Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur pjesërisht**.
- Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur kryesisht**.

Në muajin prill të vitit 2017, vlerësuesit e jashtëm i konfirmuan Këshillit të Akreditimit se Standardet Shtetërore të Cilësisë në Universitetin e Tiranës ishin përmbushur pjesërisht dhe si rrjedhojë, universiteti fitoi akreditimin nga Këshilli për një periudhë njëvjeçare.

Raporti i Vetëvlerësimit u hartua nga Grupi i Punës së Vetëvlerësimit të Brendshëm që përfshiu tetë persona nga universiteti me njohuri të thella të institucionit, dhe një përfaqësues të këshillit studentor. Përpara se të përfundonin, draftet qarkulluan te një audiencë më e gjerë brenda universitetit. Senati Akademik autorizoi publikimin e raportit përfundimtar dhe dërgimin e tij te Agjencia.

Vizita zgjati dy ditë, më 10 dhe 11 shtator 2018. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy vlerësues të nivelit të lartë për arsimin e lartë nga Mbretëria e Bashkuar dhe një anëtar stafi me përvojë për arsimin e lartë nga një institucion shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri për Vlerësimin e Jashtëm dhe një mbajtës shënimesh i punësuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mori Raportin e Vetëvlerësimit dhe portofolin me të dhënat

mbështetëse tetë javë përpara vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, më pas i plotësuar me dokumentacion shtesë, përpara dhe gjatë vizitës. Shkalla e gjerë e informacionit mbështetës të ofruar nga universiteti bëri të mundur që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm të njihet me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit, llojin e mësimdhënies dhe veprimtarinë kërkimore shkencore. Evidencat përfshinin Statutin dhe Rregulloret, raportet e brendshme, raportin vjetor për Ministrinë, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumet, shembujt rreth informacionit të programit dhe të dhëna nga mbledhjet për diskutime.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me menaxherë të nivelit të lartë, studentë, lektorë, stafin administrativ dhe mbështetës, po ashtu edhe me partnerë të jashtëm gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm. Diskutimi përfshiu sqarimin e procedurave, përgjegjësi dhe gjetjeve. Shënimet u mbajtën në të gjitha mbledhjet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi Fakultetin e Shkencave Natyrore, ku panë nga afër bibliotekën, sallat e mësimi, laboratorët dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë ose pika të dobëta, dhe nuk bëri asnjë pohim. Megjithatë, vlerësimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Senatit Akademik tregoi se gjatë procesit të miratimit të Statutit të rishikuar kishte pasur diskutime konstruktive, të ndezura dhe ndonjëherë ballafaqese. Për më tepër, procesi i miratimit ishte zvarritur disa muaj për shkak të mospjesëmarrjes së anëtarëve të Senatit Akademik në mbledhje, që solli mosplotësimin e kuorumit. Si rrjedhojë, nuk u arrit të merrej asnjë vendim, ose mbledhjet u anuluan. Gjithashtu, procesverbalet e mbledhjeve treguan një mungesë të dukshme bashkëpunimi ndërmjet Senatit dhe Bordit të Administrimit. Gjatë diskutimit të kësaj gjetjeje me stafin e nivelit të lartë u sugjerua se ky fakt tregonte se Universiteti nxiste debatin konstruktiv dhe se Senati Akademik funksiononte në një mënyrë të hapur dhe demokratike. Sipas procesverbaleve të mbledhjeve të Senatit dhe pas një shqyrtimi të kujdesshëm, ekipi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se natyra ballafaqese e debatit ishte pengesë në garantimin e një menaxhimi të efektshëm dhe efikas brenda organeve drejtuese të Universitetit dhe në veçanti të Senatit. Në këtë mënyrë, ekipi i vlerësimit të jashtëm vuri re se atmosfera e konfliktit dhe mungesa e bashkëpunimit ndërmjet dhe brenda dy organeve kolegjiale të nivelit të lartë të Universitetit ishte në kontrast të drejtpërdrejtë me mënyrën e hapur dhe të ndershme me të cilën studentët dhe stafi me të cilët u takua ekipi i vlerësimit të jashtëm ishin angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm. Megjithëse nuk identifikohet si një pikë e dobët kundrejt ndonjë Standardi specifik, si një mjet për përmirësimin dhe fuqizimin e proceseve vendimmarrëse të Universitetit, **rekomandohet** që drejtuesit e nivelit të lartë të Universitetit të ndërmarrin hapa për garantimin e një mjedisi të koordinuar, bashkëpunues dhe konstruktiv, për të mundësuar debatin dhe diskutimin në të gjitha bordet dhe komisionet e ngritura zyrtare, në mënyrë profesionale dhe kolegjiale, për të lehtësuar drejtimin e efektshëm dhe efikas të Universitetit në kohë. **(Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi II.3)** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti të konfirmonte se tre pikat e dobëta dhe rekomandimet e dhëna, të identifikuara gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm në muajin prill 2017, që i përkasin Fushës së Vlerësimit 1, janë adresuar plotësisht.

Standardet për Burimet janë **përmbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë ose pika të dobëta, dhe nuk dha asnjë rekomandim. Megjithatë, ndërsa Universiteti ofroi të dhëna të mjaftueshme për të treguar angazhimin e tij në adresimin e pikës së dobët të identifikuar gjatë muajit Prill 2017, ekipi i vlerësimit të jashtë **pohon** ndërmarrjen e veprimeve për: zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, të shëndoshë dhe të dokumentuar për vlerësimin e arritjeve dhe aftësive të stafit (**Kapitulli III, Standardi IV.3**); progresin që po bëhet për zbatimin e sistemit të ri të informacionit, duke përfshirë transferimin e të dhënave nga sistemi i vjetër (**Kapitulli III, Standardi VII.1**); progresin që po bëhet për përmirësimin e aksesueshmërisë dhe cilësisë së informacionit të disponueshëm në faqen publike të internetit (**Kapitulli III, Standardi VII.1**); dhe, hapat e ndërmarrë për përmirësimin e burimeve lidhur me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, në dobi të studentëve dhe stafit (**Kapitulli III, Standardi VII.3**). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti të konfirmonte se tre pikat e dobëta dhe rekomandimet e dhëna, të identifikuar gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm në muajin Prill 2017, që i përkasin Fushës së Vlerësimit 2, janë adresuar plotësisht.

Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të **praktikës së mirë**: lidhjet e forta dhe gjithëpërfshirëse me përfaqësuesit e sektorit publik dhe privat, të cilët e mbështesin Universitetin në dobi të studentëve (**Kapitulli I, Standardi I.12**) Për më tepër, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët dhe nuk dha asnjë rekomandim. Megjithatë, ndërsa Universiteti ofroi të dhëna të mjaftueshme për të treguar angazhimin e tij në adresimin e pikës së dobët, të identifikuar gjatë muajit të vitit 2017, grupi i vlerësimit të jashtëm pohon se ndërmarrjen e veprimeve për shtimin e numrit të programeve për shkëmbimin e studentëve dhe përmirësimin e promovimit të tyre për studentët e mundshëm (**Kapitulli I, Standardi I.10**) Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti të konfirmonte se dy pikat e dobëta dhe rekomandimet e dhëna, të identifikuar gjatë vizitës për vlerësimin e jashtëm në muajin Prill 2017, që i përkasin Fushës së Vlerësimit 3, janë adresuar plotësisht.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur kryesisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë. Megjithatë, grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dy **pika të dobëta**: paqartësinë rreth mënyrës se si ndahet financimi ndërmjet kërkuesve shkencorë ose grupeve të kërkimit shkencor dhe se kërkimi shkencor financohet kryesisht nga vetë kërkuesit shkencorë (**Kapitulli II Standardi I.1**) dhe, mungesën e një politike zyrtare të Universitetit për të zbuluar shkeljet akademike, dhe në veçanti rastet e plagjiaturës (**Kapitulli II Standardi I.8**). Si rrjedhojë, për adresimin e këtyre pikave të dobëta, grupi i vlerësimit të jashtëm dha dy **rekomandime**: hartimin dhe zbatimin e një politike zyrtare dhe kriteri për alokimin dhe shpërndarjen e fondeve për kërkimin shkencor në nivelin fakulteti dhe departamenti, si dhe të një mekanizmi të ri që i nxit departamentet që të gjenerojnë fonde për kërkimin shkencor nëpërmjet projekteve dhe veprimtarive të tjera (**Kapitulli II Standardi I.1**), si dhe hartimin dhe zbatimin nga ana e universitetit e një politike zyrtare për plagjiaturën dhe shkeljet e tjera akademike, si çështje me përparësi (**Kapitulli II Standardi I.8**). Megjithatë rekomandimi i dytë është dhënë që prej muajit vizitës së vlerësimit të jashtëm në muajin prill të vitit 2017, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

arriti të konfirmonte se tre pikat e tjera të dobëta dhe rekomandimet e dhëna, të identifikuar gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm në muajin prill 2017, që i përkasin Fushës së Vlerësimit 1, janë adresuar plotësisht. Gjithashtu, grupi i vlerësimit të jashtëm **pohon** ndërmarrjen e veprimeve nga Universiteti për të krijuar një portofol me module në që do t'i jepen në gjuhën angleze (**Kapitulli II Standardi I.6**).

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë ose pika të dobëta, dhe nuk dha asnjë rekomandim. Megjithatë, Universiteti tregoi se është angazhuar në mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për punësimin e të diplomuarve nga Qendra e Karrierës dhe grupi i vlerësimit të jashtëm **pohon** ndërmarrjen e veprimeve nga Universiteti për përbushjen e këtij synimi (**Kapitulli I, Standardi III.9**). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishte në gjendje të konfirmonte se dy pikat e dobëta dhe rekomandimet e dhëna, të identifikuar gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm në muajin prill 2017, që i përkasin Fushës së Vlerësimit 5, janë adresuar plotësisht.

Universiteti e ndërmori vlerësimin në përputhje me udhëzimet e ASCAL-it. Grupi i vlerësimit të jashtëm e vlerëson nivelin e angazhimit të Universitetit në proces dhe bashkëpunimin e grupit të vlerësimit të jashtëm përgjatë gjithë vizitës. Në veçanti, grupi i vlerësimit të jashtëm lavdëroi punën e Grupit të Vetëvlerësimit në ofrimin e një baze të gjithëpërfshirëse evidencash dhe Koordinatorin Institucional për vëmendjen që i kushtoi grupit të vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës së tyre. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhej nga Z. Grant Horsburgh (Kryetar), Z. Kevin Kendall dhe Prof. As. Ana Mane (Vlerësuese të jashtme).

Përmbledhje e Gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- lidhjet e forta dhe gjithëpërfshirëse me përfaqësuesit e sektorit publik dhe privat, të cilët e mbështesin Universitetin në dobi të studentëve (**Kapitulli I, Standardi I.12**)

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pikat e dobëta të mëposhtme:

- paqartësinë rreth mënyrës se si ndahet financimi ndërmjet departamenteve ose grupeve të kërkimit shkencor dhe se kërkimi shkencor financohet kryesisht nga vetë kërkuesit shkencorë (**Kapitulli II Standardi I.1**)
- mungesën e një politike zyrtare të Universitetit për të zbuluar shkeljet, dhe në veçanti rastet e plagjiaturës (**Kapitulli II Standardi I.8**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- ndërmarrjen e hapave nga drejtuesit e nivelit të lartë të Universitetit për garantimin e një mjedisi të koordinuar, bashkëpunues dhe konstruktiv, që mundëson debatin dhe diskutimin në të gjitha bordet dhe komisionet e ngritura zyrtare, në mënyrë profesionale dhe kolegiale, për të lehtësuar drejtimin e efektshëm dhe efikas të Universitetit në kohë. **(Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi II.3)**
- hartimin dhe zbatimin e një politike formale dhe kriteri për alokimin dhe shpërndarjen e fondeve për kërkimin shkencor në nivel fakulteti dhe departamenti, si dhe një mekanizëm që i nxit departamentet të gjenerojnë fonde për kërkimin shkencor nëpërmjet projekteve dhe veprimtarive të tjera **(Kapitulli II Standardi I.1)**
- hartimin dhe zbatimin nga ana e Universitetit të një politike zyrtare për plagjiaturën dhe shkeljet e tjera akademike, si çështje me përparësi **(Kapitulli II Standardi I.8)**.

Pohime mbi veprimet e ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon ndërmarrjen e veprimeve të mëposhtme:

- angazhimi i Universitetit për ofrimin e një game dokumentesh rregullatore dhe procedurale
- progresi për zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, të shëndoshë dhe të dokumentuar për vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të stafit **(Kapitulli III, Standardi IV.3)**
- progresi për zbatimin e një sistemi të ri informacioni, duke përfshirë transferimin e të dhënave nga sistemi i vjetër **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**
- progresi për përmirësimin e aksesueshmërisë dhe cilësisë së informacionit të disponueshëm në faqen publike të internetit **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**
- hapat për përmirësimin e burimeve për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në dobi të studentëve dhe stafit **(Kapitulli III, Standardi VII.3)**
- hapat për shtimin e numrit të programeve për shkëmbimin e studentëve dhe përmirësimin e promovimit të tyre për studentët e mundshëm **(Kapitulli I, Standardi I.10)**
- krijimin e një portofoli me module që do të jepen në gjuhën angleze **(Kapitulli II Standardi I.6)**
- hapat për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për punësimin e të diplomuarve nga Qendra e Karrierës **(Kapitulli I, Standardi III.9)**.

Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**.
2. Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht**.
3. Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.
4. Standardet për Mësimdhënien, të Nxënit, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin e Tiranës se Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Pas vizitës në muajin prill të vitit 2017, Universiteti hartoi një Statut të rishikuar me qëllim bashkërendimin me kërkesat ligjore kombëtare për institucionet e arsimit të lartë. **[RVV f. 6; ASCAL 6]** Statuti i rishikuar përcakton misionin, organizimin e brendshëm dhe strukturat drejtuese të Universitetit. **[AE1]** Megjithëse Statuti i rishikuar tregon se Universiteti ka ndërmarrë veprime për adresimin e pikës së dobët të identifikuar gjatë vizitës së muajit Prill 2017, në kohën e kryerjes së vizitës Statuti i rishikuar nuk ishte miratuar përfundimisht nga Senati Akademik. **[RVV f. 6; ASCAL 6; AE3.2; M11 & M12]** Stafi i nivelit të lartë tregoi se procesi i miratimit për Statutin e rishikuar ishte në një fazë të avancuar dhe pas vizitës Universiteti i konfirmoi ASCAL-it se Statuti i rishikuar ishte miratuar nga Senati Akademik. **[M11 & M12; Procesverbali i Senatit, më 14 shtator 2018]** Stafi i nivelit të lartë pranoi se miratimi i Statutit do të ishte fillimi i një procesi të vazhdueshëm për të integrimin dhe bashkërendimin e plotë të rregulloreve dhe strukturave të brendshme. **[M11 & M12] (Kapitulli III, Standardi I.1)**

1.2 Universiteti është organizuar në mënyrë që të sigurojë efikasitet në menaxhim, në përputhje me kërkesat ligjore. **[RVV f. 6 & 7; ASCAL 5 & 8; dokumentet RVV 1.1 & 1.2]** Rrjedha e informacionit nga departamentet në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit, dhe shpallja e vendimeve të tyre për dijeni të stafit dhe studentëve, është e efektshme. **[AE3.2 & 3.4; M3-7]** Rregullimet për menaxhimin dhe administrimin e Universitetit dhe vendimmarrjen kolegjiale marrin parasysh pritshmëritë ligjore dhe kuptohen nga të gjithë anëtarët e satit në të gjitha nivelet. **[AE3.2 & 3.4; M3-7 & 11] (Kapitulli III, Standardi I.2)**

1.3 Shqyrtimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Senatit Akademik tregoi se gjatë procesit të miratimit të Statutit të rishikuar kishte pasur diskutime konstruktive, të ndezura dhe ndonjëherë ballafaquese. **[AE3.2]** Për më tepër, procesi i miratimit ishte zvarritur disa muaj për shkak të mospjesëmarrjes së anëtarëve të Senatit Akademik në mbledhje, që solli mosplotësimin e kuorumit. Si rrjedhojë, nuk u arrit të merrej asnjë vendim, ose mbledhjet u anuluan. **[AE3.2]** Gjithashtu, procesverbalet e mbledhjeve treguan një mungesë të dukshme bashkëpunimi ndërmjet Senatit dhe Bordit të Administrimit. **[AE3.2]** Gjatë diskutimit të kësaj gjetjeje me stafin e nivelit të lartë u sugjerua se ky fakt tregonte se Universiteti nxiste debatin konstruktiv dhe se Senati Akademik funksiononte në një mënyrë të hapur dhe demokratike. **[M11]**

1.4 Sipas procesverbaleve të mbledhjeve të Senatit dhe pas një shqyrtimi të kujdesshëm, ekipi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se natyra ballafaquese e debatit ishte pengesë në garantimin e një menaxhimi të efektshëm dhe efikas brenda organeve drejtuese të Universitetit dhe në veçanti të Senatit. Në këtë mënyrë, ekipi i vlerësimit të jashtëm vuri re se atmosfera e konfliktit dhe mungesa e bashkëpunimit ndërmjet dhe brenda dy organeve kolegjiale të nivelit të lartë të Universitetit ishte në kontrast të drejtpërdrejtë me mënyrën e hapur dhe të ndershme me të cilën studentët dhe stafi me të cilët u takua ekipi i vlerësimit të jashtëm ishin angazhuar në

procesin e vlerësimit të jashtëm. **[M2-8 & 10-12]** Megjithëse nuk identifikohet si një pikë e dobët kundrejt ndonjë Standardi specifik, si një mjet për përmirësimin dhe fuqizimin e proceseve vendimmarrëse të Universitetit, **rekomandohet** që drejtuesit e nivelit të lartë të Universitetit të ndërmarrin hapa për garantimin e një mjedisi të koordinuar, bashkëpunues dhe konstruktiv, për të mundësuar debatin dhe diskutimin në të gjitha bordet dhe komisionet e ngritura zyrtare, në mënyrë profesionale dhe kolegiale, për të lehtësuar drejtimin e efektshëm dhe efikas të Universitetit në kohë. **(Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi II.3)**

1.5 Bordet dhe këshillat mbledhen rregullisht dhe informacioni për pikat e rendit të ditës i shpërndahet paraprakisht të gjithë stafit në mënyrë elektronike. **[RVV f. 7, 8 & 11; ASCAL 21, 22, 24, 25 & 32; dokumentet RVV 1.22, 1.22.1, 1.25, 1.25.1 & 1.42; AE3.1 & 3.3; M3-7]** Studentët dhe stafi treguan se çështjeve të ngritura prej tyre po i kushtohet vëmendja e duhur përmes debatit konstruktiv në të gjitha komisionet e ngritura zyrtarisht. **[M3-7]** Stafi dhe studentët i kuptojnë rregullimet për funksionimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrëse dhe për mbështetjen e diskutimit dhe debatit kolegjal. **[M3-7]** Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve janë të përgjegjshëm për monitorimin lokal të zbatimit të vendimeve të marra nga bordet dhe këshillat e ngritur zyrtarisht. **[M6, 7, 11 & 12] (Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi II.3)**

1.6 Universiteti siguron respektimin e kufijve të autonomisë së tij dhe funksionimin brenda kufijve të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. **[RVV f. 8 & 9; ASCAL 5, 6, 23, 29 & 32; dokumentet RVV 1.1, 1.23, 1.35 & 1.42; M7, 8, 11 & 12]** Vetëqeverisja është e dukshme në njësitë organizative akademike dhe administrative, në veprimtaritë mësimdhënëse dhe shkencore, si dhe në çështjet financiare dhe administrative. **[AE3.2 & 3.4; M7, 8, 11 & 12]** Zyra për Marrëdhëniet me Jashtë është përgjegjëse për t'u siguruar se Universiteti përfiton nga programet me financim evropian dhe se ka ndihmuar në lidhjen e marrëveshjeve me institucionet e arsimit të lartë në një sërë vendesh, duke përfshirë Austrinë, Italinë, Rumaninë dhe Mbretërinë e Bashkuar. **[RVV f. 9; ASCAL 23, & 26-28; dokumentet RVV 1.23 & 1.28-1.30; M7]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë luan një rol kyç në monitorimin dhe analizimin e efektshmërisë së veprimtarive të vlerësimit të brendshëm. **[RVV f. 8; ASCAL 100 & 114 (në gjuhën shqipe); dokumentet RVV 1.17 & 1.34 (në gjuhën shqipe); M8 & 12]** Njësia përbëhet nga përfaqësues nga ngarkohet nga çdo fakultet dhe Senati Akademik për të ndërmarrë projekte të veçanta të vlerësimit të brendshëm. Anëtarët e Njësisë luajtën një rol kyç në hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit. **[M8 & 12]** Stafi pranoi se dokumentacioni ekzistues lidhur me rolin e Njësisë ishte i disponueshëm vetëm në gjuhën shqipe, prandaj Universiteti u angazhua në ofrimin e një sërë dokumentacionesh rregullatore dhe procedurale në gjuhën angleze. **[M8, 11 & 12]** Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë nga Universiteti për përkthimin e shumë dokumenteve rregullatore dhe procedurale në gjuhën angleze. Megjithëse Universiteti fton këshilluesit akademikë të jashtëm për të marrë pjesë në hartimin dhe rishikimin e programeve, këta këshillues nuk janë përfshirë në hartimin e procedurave që lidhen me sigurimin e cilësisë së brendshme. **[RVV f. 9; M8 & 11] (Kapitulli III, Standardi I.4)**

1.7 Universiteti ka një Strategji të përshtatshme Zhvillimi për periudhën 2018-2023, që është miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. **[RVV f. 9; ASCAL 17; dokumentet RVV 1.12]** Strategjia u hartua nga një grup pune i përkushtuar, anëtarësia e të cilit u miratua nga Senati Akademik. **[RVV f. 9]** Studentët dhe stafi konfirmuan se konsultimi për Strategjinë u bë nëpërmjet versioneve paraprake të disponueshme në faqen zyrtare të Universitetit. **[M3-7, 11 & 12]** Miratimi i Strategjisë së Zhvillimit 2018-2023 tregon se Universiteti ka ndërmarrë veprime për adresimin e pikës së dobët të identifikuar gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm në muajin prill të vitit 2017. **(Kapitulli III, Standardi I.5)**

1.8 Raporti vjetor për Ministrinë ofron të dhëna për mësimdhënien dhe programet e studimit, kërkimin shkencor, stafin, veprimtaritë me projekte dhe çështjet ekonomike dhe financiare. **[RVV f. 9-10; ASCAL 23; dokumentet RVV 1.23; AE18]** Procesi i hartimit drejtohet nga Dekanët e Fakulteteve dhe mbështetet në raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të vetëvlerësimit për veprimtarinë e departamenteve dhe programet e studimit. Raporti përfundimtar është iu vu në dispozicion bordeve dhe komisioneve përkatëse në të gjitha institucionet, si dhe stafit dhe studentëve përmes faqes zyrtare të internetit. **[RVV f. 9-10; M3-7, 11 & 12]** Raportet e tij vjetore për Ministrinë të viteve 2016-2017 dhe 2017-2018 u përfshinë në bazën e evidencave të këtij vlerësimi, çka tregon se Universiteti ka ndërmarrë veprime për të adresuar plotësisht një pikë të dobët që u identifikua gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm në muajin prill 2017. **[ASCAL 23; dokumentet RVV 1.23; AE18] (Kapitulli III, Standardi I.6)**

1.9 Fakultetet dhe departamentet janë të organizuara në përputhje me kërkesat ligjore. **[RVV f. 10 & 11; ASCAL 5, 6 & 29; dokumentet RVV 1.1, 1.1.1 & 1.35; Informacion mbi IAL-të në faqen e ASCAL]** Strukturat menaxhuese, ekzekutive, dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. **[RVV f. 10 & 11; M6-8, 11 & 12]** Stafi akademik ka kualifikimet e duhura dhe gëzon autonomi dhe liri akademike në mësimdhënie, në kërkim shkencor dhe në të gjitha veprimtaritë e tjera akademike. **[RVV f. 10 & 11; M6-8, 11 & 12]** Universiteti ka një faqe zyrtare interneti dhe ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, në përputhje me statusin e tij ligjor. **[RVV f. 10 & 11; ASCAL 5, 6 & 29; dokumentet RVV 1.1, 1.1.1 & 1.35; Informacion mbi IAL-të në faqen e ASCAL] (Kapitulli III, Standardi II.1)**

1.10 Në përgjigje të pikës së dobët të identifikuar gjatë vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në muajin prill të vitit 2017, Senati Akademik autorizoi një projekt mbarëuniversitar për studimin e tregut, ku përfshiheshin të gjitha fakultetet me qëllim garantimin se programet e tyre vazhdojnë të jenë në përputhje me reformën dhe zhvillimet ekonomike në të gjithë vendin. **[RVV f. 11 & 12; ASCAL 18; RVV dok 1.18; AE9, 10, 11.1 & 11.2; M3-8, 11 & 12]** Krahas kësaj, rezultati i studimit të tregut nxiti hartimin e Strategjisë së Zhvillimit 2018-2023. **[RVVf11 & 12; M11]** Studimi i tregut tregon se universiteti ka ndërmarrë veprime për të adresuar plotësisht një pikë të dobët të identifikuar vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në muajin mars të vitit 2017. Universiteti ka një rrjet të gjerë dhe gjithëpërfshirës partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, që përfshin institucionet e arsimit të lartë, organe publike dhe firma të pavarura. **[RVVf11 & 12; ASCAL 26-28; RVV dok 1.28-1.30; AE12.1 & 12.2; M3-7 & 10-12]** Studentët, stafi akademik, alumnit dhe ofruesit e sistemimit në praktikë treguan se ekzistojnë lidhje të ngushta midis programeve, departamenteve dhe organizatave vendore dhe rajonale për ofrimin e

praktikave të studentëve, mundësive për punësim, si dhe shërbimeve dhe mbështetjes specifike sipas lëndëve.[M3-7 & 10-12]Monitorimi statistikor i punësueshmërisë së studentëve të diplomuar ndërmerret nga Qendrat e Karrierës në Fakultete dhe diskutohet në pikën 5.9. **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2; Kapitulli III, Standardi III.3)**

1.11 Universiteti ka lidhur një sërë marrëveshjesh formale, që iu ofrojnë stafit dhe studentëve mundësinë për të marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare.[RVVf13 & 14; ASCAL 26-29; RVV dok 1.28-1.30; M3-7 & 10-12]Stafi i lartë e njih vlerën e pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në veprimtari ndërkombëtare dhe kjo temë është përfshirë si element kyç në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2023. [ASCAL 17; RVV dok 1.12] Studentët dhe stafi konfirmojnë se Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare publikon informacione në faqen e universitetit në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve.[M3-7; M12]Stafi i lartë komentoi se rritja e publicitetit të mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve u konsideruar i suksesshëm, pasi për secilën hapësirë në dispozicion kishte tri deri në katër aplikime.[M2 & 11]U vërejt se gjatë periudhës 2017-2018, universiteti plotësoi 213 nga 402 hapësirat e disponueshme për mobilitetin e stafit dhe të studentëve në mbarë Shqipërinë.[M11]Gjatë kohës së vlerësimit të jashtëm, universiteti kishte një numër të vogël studentësh ndërkombëtarë. Në rastet që ishte e mundur, është ndërmarrë një ushtrim për krahasimin e programit midis programeve të universitetit dhe programeve në vendet e tyre për të identifikuar boshllëqet në kurrikul, dhe ofrohet mësimdhënie e mëtejshme për mbulimin e mungesave.[M11](**Kapitulli III, Standardi III.4**)

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët në këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- drejtuesit e nivelit të lartë të universitetit të ndërmarrin hapa për të garantuar krijimin e një mjedisi të bashkërenduar, bashkëpunues dhe konstruktiv, që bën të mundur që debatet dhe diskutimet në të gjitha bordet dhe komisionet formale realizohen në mënyrë profesionale dhe kolegjinale për të lehtësuar qeverisjen dhe menaxhimin efikas dhe të efektshëm të universitetit në mënyrën e duhur. **(Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi II.3).**

Pohim për veprimet e ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se veprimet në vijim janë duke u ndërmarrë:

- angazhimi i universitetit për të ofruar dokumentacion të gjerë rregullator dhe procedural **(Kapitulli III, Standardi I.4).**

Gjykim

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Struktura organizative e universitetit diskutohet dhe propozohet në Senatin Akademik dhe miratohet nga Bordi i Administrimit. **[ASCAL 7 & 13; AE 3.3; M11 & 12]**Në faqen e universitetit publikohet një organigramë. **[www.unitir.edu.al]**Kjo strukturë parashtrohet për menaxhimin e burimeve me qëllim përmbushjen e Standardeve Shtetërore të Cilësisë. **[ASCAL 5 & 6]**Kriteret e punësimit për secilin pozicion pune të lirë përcaktohen në Statut dhe departamentet janë në gjendje të shtojnë kriteret e reja nëse miratohen nga Rektori.**[RVVf15; ASCAL 5 & 6]** Pozicionet e lira të punës reklamohen në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe postat janë të hapura si për aplikimet e brendshme ashtu edhe për ato të hapura.**[www.app.gov.al]**Stafi i jashtëm punësohet sipas nevojave të departamentit për mësimdhënie dhe kërkim. **[ASCAL 5]**Kriteret për përzgjedhjen e stafit dhe procedurat për rekrutim përcaktohen në Rregulloret e Universitetit.**[ASCAL 8]**Procedura për punësimin e stafit akademik, shkencor dhe administrativ ndjek të njëjtin proces dhe mbështetet në pjesët përkatëse të Statutit, Rregulloreve dhe ligjit përkatës.**[ASCAL 5, 6 & 8; RVV dok 2.1.1 & 2.6]** Universiteti ka punësuar staf akademik nga universitete të njohura ndërkombëtarisht me kalimin e viteve, dhe stafi akademik pritet të ketë përvojë në një universitet perëndimor.**[RVV dok 2.2]**Strategjia për Zhvillimin e Universitetit parashikon se tërheqja e stafit akademik dhe studentëve të huaj është objektive.**[ASCAL 17]**Stafi akademik shprehet se disa profesorë vijnë nga jashtë vendit dhe kanë një listë lëndësh që mund t'i ofrojnë në gjuhën angleze, si dhe universiteti ka qenë më aktiv këtë vit në publikimin e aplikimeve për mobilitet.**[M2, 6 & 7]** Universiteti ofron një strukturë administrative si në nivel universitar dhe fakulteti, që ofron shërbime sipas nevojës.**[M6 & 7](Kapitulli III, Standardi IV.1; Kapitulli III, Standardi VII.6)**

2.2 Statuti përcakton se pedagogëve dhe hulumtuesve iu garantohet autonomi dhe liri akademike për mësimdhënie dhe kërkimin në pajtim dhe pa penguar arritjen e objektivave dhe programeve të kurrikulës.**[ASCAL 5, Neni 6]** Universiteti ka 1,093 punonjës me kohë të plotë, 779 prej të cilëve janë staf akademik dhe 314 janë staf administrativ dhe ndihmës, si dhe 982 pedagogë të jashtëm. Universiteti e mbështet angazhimin e stafit në veprimtaritë e jashtme dhe iu jep të drejtën të kthehen në vendin e punës më vonë.**[ASCAL 127]**Nga pikëpamja e brendshme, stafi angazhohet në workshop-e, ditë informimi, evente promovionale dhe veprimtari sociale të organizuara nga universiteti.**[ASCAL 3; M6](Kapitulli III, Standardi IV.2)**

2.3 Universiteti organizon veprimtari trajnuese si për stafin akademik ashtu edhe për atë administrativ sipas përparësive të universitetit.[ASCAL 17; RVV dok 2.4, 4.19 & 4.20; M6]Vlerësimi i stafit përqendrohet në tri fusha kryesore, përkatësisht: mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe veprimtaritë administrative, sipas përcaktimeve në Manualin për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik dhe mbështetet nga Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë.[RVV dok 1.8 & 2.1]Përgjegjësit e Departamenteve çdo vit përcaktojnë objektiva për stafin, sipas rolit që kanë, dhe në fund të vitit pjesëtarët e stafit plotësojnë një formular vetëvlerësimi.[RVV dok 2.1.2]Evidencat merren nga pyetësorët e studentëve në internet, të cilët plotësohet në fund të çdo semestri apo pas mësimdhënies, kërkimit apo publikimeve, mobilitetit dhe vlerësimit nga Përgjegjësi i Departamentit.[M4, 6 & 11]Më parë, ky sistem konsiderohej se kishte pika të dobëta në zbatimin konsistent të dokumentuar në fakultete, por këtë vit është forcuar ndjeshëm me procedurën e re, që do të zbatohet gjatë vitit të ardhshëm akademik.[RVV dok 2.1; M6, 7 & 12]Ndaj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** ecurinë pozitive që po bëhet për të zbatuar një procedurë gjithëpërfshirëse, të shëndoshë dhe të dokumentuar për vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të stafit. Universiteti e mbështet trajnimin e stafit në universitetet perëndimore në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe projekte ndërkombëtare, si për shembull Erasmus+. [ASCAL 2.16; RVV dok 1.23, 2.4, 4.15, 4.15.2 & 4.32] Universiteti ndjek praktikën e ftesës së profesorëve të huaj nëpër komisione që japin titullin akademik ‘profesor’ dhe kandidatët për këtë titull duhet të kenë kaluar të paktën një vit akademik apo të kenë zhvilluar veprimtari kërkimore në një universitet perëndimor.[RVV dok 2.30 & 2.30.1](*Kapitulli III, Standardi IV.3*)

2.4 Universiteti synon mbështetjen e veprimtarive sociale për stafin dhe studentët, si dhe nxit dialogun social duke organizuar mbledhje të hapura me personalitete nga fusha të ndryshme veprimtarish.[ASCAL 3; M3 & 6] Universiteti veç kësaj promovon dialogun duke përfshirë stafin në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe konsultimit, çka i referohen me qasjen “poshtë-lart” të stafit të lartë të universitetit, që u konfirmua edhe nga stafi akademik.[M2 & 11] Universiteti vepron në përputhje me kuadrin ligjor për sigurimin shëndetësor dhe social, si dhe i paguan detyrimet e tij dhe ofron mbështetje financiare në rastet e fatkeqësive familjare ose sëmundjeve të rënda.[RVV dok 2.3.1](*Kapitulli III, Standardi IV.4*)

2.5 Stafi i universitetit ka kontrata në përputhje me legjislacionin, dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit janë në pajtim me Statutin, Rregulloret dhe Kodin e Etikës.[RVV dok 1.1, 1.2, 1.2.1 & 1.5]Dokumentet përkatëse ruhen në arkivin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.[M6 & 7](*Kapitulli III, Standardi II.2*)

2.6 Universiteti ka pavarësi financiare në hartimin e buxhetit në përputhje me Statutin.[RVV dok 1.1 Neni 85]Hartimi i buxhetit është një proces nga poshtë-lart me propozime që departamentet t'i dorëzojnë shpenzimet në fakultet. Fakultetet i përfshijnë më pas në buxhetin e fakultetit, që dorëzohet tek Administratori i Fakultetit. Administratori është përgjegjës për hartimin e projektbuxhetit për rishikim nga Rektorati dhe Senati Akademik, si dhe për garantimin e mbështetjes së Strategjisë së Zhvillimit.[RVV dok 1.6.1, 2.9 & 1.12]Projektbuxheti përfundimtar më pas shkon për diskutim dhe miratim në Bordin e Administrimit.[RVV dok 1.1 &

2.12]Buxheti më pas delegohet te fakultetet për zbatim.**[RVV dok 2.10](Kapitulli III, Standardi VI.1)**

2.7 Universiteti ka mjetet e nevojshme për të zbatuar politikat financiare nëpërmjet strukturave dhe proceseve të tyre. Administratori dhe Bordi i Administrimit mbikëqyrin dhe kontrollojnë menaxhimin financiar dhe garantojnë pajtimin përputhshmërinë me rregullat e kontabilitetit.**[RVV dok 1.1]**Strukturat mbështetëse përfshijnë Sektorin e Financës, Drejtorinë e Prokurimit dhe Investimit, Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Rektorat, si dhe mbajtësit e buxheteve në çdo fakultet dhe departament.**[RVV dok 1.2.1; M2, 6-8 & 11]**Ndaj, universiteti ka procedura transparente për menaxhimin e burimeve financiare dhe është në përputhje me kërkesat statutorë, si dhe publikon buxhetin e miratuar në faqen e internetit dhe informon të gjithë anëtarët e stafit akademik nëpërmjet email-it. **[RVV dok 2.13; www.unitir.edu.al]**Buxheti përfundimtar dorëzohet në Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit sipas rregulloreve. Zbatimi i buxhetit nga fakultetet monitorohet duke paraqitur raporte në Rektorat çdo tre muaj.**[RVV dok 2.27, 2.27.1 & 2.27.2](Kapitulli III, Standardi VI.2)**

2.8 Kontrolli buxhetor dhe financiar realizohet nga auditimi i brendshëm në universitet, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, si dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë.**[www.klsk.org.al/web/vendimi_97_matura_2016_3768.pdf]**Njësia e Auditimit të Brendshëm organizohet nëpërmjet Bordit të Administrimit dhe në përputhje me një auditim në nivel departamenti apo fakulteti do të hartojë një raport për gjetjet drejtuar Bordit të Administrimit.**[RVV dok 1.1 art 85 & 86 & 2.29]** Raportet financiare dorëzohen te Senati, i cili zhvillon mbledhje të hapura me përfaqësuesit e studentëve dhe stafit, si dhe raportet e auditimit publikohen në faqen e internetit të universitetit. **[M3, 6 & 11; www.unitir.edu.al]**Stafi tregoi se të ardhurat nga tarifat e studentëve përdoren për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe shërbimet për studentët.**[M6, 7, 11 & 12](Kapitulli III, Standardi VI.3)**

2.9 Sistemi për menaxhimin e informacionit në universitet nuk ka qenë funksional që prej gushtit të vitit 2017. **[RVV dok 2.25 & 2.26]**Megjithatë, stafi dhe studentët i mbështesin përpjekjet e vazhdueshme të universitetit për ta zgjidhur këtë problematikë dhe treguan se mungesa e sistemit të menaxhimit të informacionit nuk iu shkakton probleme në një periudhë afatshkurtër.**[M3-7 & 11]**Me punën e universitetit për të përmbushur detyrimet në këtë drejtim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** ecurinë e universitetit drejt zbatimit të sistemit të ri të informacionit, duke përfshirë edhe transferimin e të dhënave nga sistemi i vjetër. Në faqen e tij të internetit, universiteti publikon veprimtari sociale, akademike dhe institucionale, kuotat e pranimit, numrin e studentëve në program, Statutin, Rregulloret dhe një sërë informacionesh për universitetin.**[www.unitir.edu.al]**Cilësia dhe aksesueshmëria e informacioneve në faqen publike është përmirësuar ndjeshëm gjatë vitit të fundit, çka konfirmohet nga stafi dhe studentët.**[M3-6 & 12]**Megjithatë, parashikohen përmirësime të mëtejshme nga universiteti, në mënyrë që të jetë më dinamike, ndërvepruese dhe e disponueshme në gjuhën angleze.**[M12]**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** ecurinë e universitetit për përmirësimin e aksesueshmërisë dhe cilësisë së informacionit të disponueshëm në faqen publike të internetit.**(Kapitulli III, Standardi VII.1)**

2.10 Intraneti dhe interneti i universitetit është i disponueshëm në të gjitha fakultetet, dhe secili fakultet ka një sërë sallash kompjuterike që përdoren nga studentët bashkë me programet përkatëse.**[RVV dok 2.31]**Stafi dhe studentët thanë se kompjuterat dhe programet e ofruara nga universiteti janë të përshtatshme për nevojat e tyre.**[M3-6] (Kapitulli III, Standardi VII.2)**

2.11 Universiteti ka një historik të pasurive të tij të paluajtshme.**[RVV dok 2.15, 2.31 & 2.31.1]**Ai monitoron nga afër përdorimin e burimeve sipas kërkesave për mësimdhënie dhe kërkim.**[RVV dok 2.31.1, 2.11, 2.18 & 2.19]**Një nga objektivat kryesore në Strategjinë e Zhvillimit është përmirësimi i infrastrukturës, që synon për ofrimin e burimeve të përmirësuara të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.**[RVV dok 1.12]**Bordi i Administrimit ka miratuar propozimin për përmirësimin e Fakultetit të Ekonomisë, Fakultetit të Shkencave Sociale, dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, si dhe ndërtimin e një godinë të re për Fakultetin e Juridikut gjatë periudhës 2018-2019. **[RVV dok 1.6.1 & 2.15.1; M11 & 12]**Gjatë vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në prill 2017, mjaftueshmëria e mjedisit dhe infrastrukturës u identifikua si pikë e dobët dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm tani **pohon** hapat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar mësimdhënien dhe burimet shkencore në përfitim të studentëve dhe stafit.**(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5)**

2.12 Universiteti ka një trashëgimi akademike dhe kulturore të pasur, dhe i arkivon botimet e stafit akademik, si dhe tezat e doktoraturës dhe diplomës të përgatitura nga studentët, të cilat zakonisht ruhen në bibliotekat e secilit fakultet. Universiteti synon ngritjen e një shtëpie botuese me qëllim rritjen e bashkëpunimit midis njësive kërkimore në universitet.**[RVV dok 4.16](Kapitulli III, Standardi VII.4)**

2.13 Universiteti zotëron auditorë, laboratorë, hapësira për stafin administrativ dhe akademik, biblioteka dhe salla kompjuterike. Ai e monitoron përdorimin e tyre nga afër dhe ka përgatitur një orar të zgjatur nga ora 8.00 për të përmbushur nevojat e mësimdhënies.**[ASCAL 3; M3 & 6]**Godinat dhe infrastruktura e universitetit janë të ndërtuara me një standard të përshtatshëm, që përmbush standardet higjienike dhe sanitare për studentët dhe stafin.**[Turi i burimeve]**Turi i burimeve të të nxënit tregoi një mjedis të mirë për mësimdhënie, në largësi nga zonat industriale dhe nuk dukej i ndotur.**[Turi i burimeve](Kapitulli III, Standardi V.1)**

2.14 Zyra e Protokollit në Rektorat dhe në secilin fakultet përdoret për ruajtjen e kopjeve të dokumenteve në format të shtypur.**[RVV dok 1.2.1, 1.35, 2.21 & 2.21.1]**Të dhënat statistikore mbledhen nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, si dhe raportohen çdo vit në Ministri.**[RVV dok 2.23 & 2.23.1]**Sekretaritetë akademike të fakultetit janë përgjegjëse për ruajtjen e të dhënave, si regjistrat, regjistrimi dhe notat e studentëve.**[RVV dok 2.24](Kapitulli III, Standardi V.2)**

Gjetjet

Praktika e mirë

2.15 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët në këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim në këtë Fushë Vlerësimi.

Pohim për veprimet e ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se veprimet në vijim janë duke u ndërmarrë:

- ecuria pozitive për zbatimin e një procedure gjithëpërfshirëse, të shëndoshë dhe të dokumentuar për vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të stafit (**Kapitulli III, Standardi IV.3**)
- ecuria për zbatimin e një sistemi të ri informacioni, duke përfshirë transferimin e të dhënave nga sistemi i vjetër (**Kapitulli III, Standardi VII.1**)
- ecuria për përmirësimin e aksesueshmëria dhe cilësisë së informacioneve të disponueshme në faqen publike (**Kapitulli III, Standardi VII.1**)
- hapat që po ndërmerren për të përmirësuar burimet e mësimdhënies dhe shkencore në përfitim të studentëve dhe të stafit (**Kapitullin III, Standardi VII.3**).

Gjykim

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Universiteti ofron 174 programe një tri nivele studimi, përkatësisht Bachelor, Master dhe doktoraturë. Lëndët ofrohen nga fakultetet e shkencave të natyrës, ekonomisë, juridikut, filologjisë, gjuhëve të huaja, dhe shkencave sociale, si dhe baza e të dhënave është përditësuar që prej vlerësimit të prillit 2017. **[RVV dok 3.1]**Hollësitë e secilit program, për shembull qëllimet, objektivat, struktura e kurseve dhe vlerat e krediteve janë të disponueshme në faqet e internetit të fakulteteve, të cilat aksesohen nëpërmjet faqes kryesore të universitetit.**[www.unitir.edu.al]** Studentët konfirmojnë se kanë akses në të gjitha informacionet që iu nevojiten, si para ashtu edhe gjatë kursit, nëpërmjet faqes së internetit.**[M3-5]**Programet e studimit hartohen në përputhje me përparësitë e identifikuar në Strategjinë e Zhvillimit dhe kërkesat për kualifikimet e studentëve përshkruhen në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit.**[RVV dok 1.12; M11]**Programet e studimit janë koherente dhe përshkruajnë se çfarë është i aftë të bëjë pas diplomimit një student.**[RVV dok 1.12, 3.3, 3.3.1 & 3.3.2]** Studentët konfirmojnë se janë në dijeni të këtij fakti.**[M3-5]**Veç kësaj, të diplomuarit marrin një suplement diplome që përshkruan nivelin, përmbajtjen dhe notat e arritura nga studenti. **[RVV dok 3.10]** Universiteti bashkëpunon me Ministrinë për sa i përket kurrikulës së shkollës së mesme dhe Qendrat e Karrierës së çdo fakultet organizojnë ditë informimi për t'iu dhënë studentëve të shkollave të mesme informacione për programet, kriteret e përzgjedhjes, programeve mësimore, stafit akademik, dhe fushave të mundshme të punësimit.**[RVV dok 3.4, 3.4.1 & 3.4.2]**Çdo janar fakultetet propozojnë numrin e studentëve të ciklit Bachelor dhe Master që do të pranohen, si dhe kriteret e pranimit për vitin akademik të radhës.**[RVV dok 1.1 art 49, 1.2, 1.3, 3.5, 3.5.1, 3.5.2 & 3.5.3]**Gjatë javës së parë të vitit akademik, studentët njihen me mjediset dhe stafit, çka konfirmohet të jetë veprimtari e dobishme.**[RVV dok 3.2, 3.2.1, 3.2.2 & 3.2.3; M3](Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.3; Kapitulli 1, Standardi 1.6)**

3.2 Universiteti ofron kurse të shkurtra (shkolla verore/dimërore) në fusha të specializuara për të ofruar njohuri dhe aftësi për të nxënëit gjatë gjithë jetës në një sërë fushash. Studentët e këtyre kurseve marrin një certifikatë pas përfundimit të tyre.**[RVV dok 3.6, 3.6.1, 3.6.2, 3.6.3, 3.6.4, 3.6.5, 3.8 & 3.8.1]**Oraret përshtaten për të plotësuar kërkesat e studentëve, për shembull shumica e programeve të studimeve Master janë caktuar pasdite, në mënyrë që studentët të kenë mundësinë të punojnë paradite për të financuar studimet.**[RVV dok 3.7; M4]**Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë luan rol në vlerësimin e suksesit të programeve, si dhe është pjesë e raporteve të vetëvlerësimit të fakulteteve.**[RVV 1.1 Neni 29; M8](Kapitulli I, Standardi I.2)**

3.3 Programet e studimit hartohen në përputhje me procesin e Bolonjës për sa i përket strukturës, niveli dhe vlerave të krediteve, si dhe janë në pajtim me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020), që synon përmbushjen e nevojave të tregut në vend.**[ASCAL 3; www.unitir.edu.al]** Studentët, stafi dhe drejtuesit e bizneseve thanë se një pjesë e madhe e pozicioneve në Tiranë plotësohen nga të diplomuarit e universitetit.**[M2-7 7 10]** Universiteti ofron disa programe ndërdisiplinore në fakultete, si për shembull programi i Masterit profesional në Menaxhimin e Shëndetit për të adresuar një nevojë të identifikuar për punësim

në Shqipëri.[RVV dok 3.12]Veç kësaj, ofron disa programe Masteri të përbashkëta me universitete evropiane partnere, si dhe lëshon diploma të përbashkëta.[RVV dok 3.11 & 3.13-16]Studentët e mundshëm në programet e Masterit dhe doktoraturës duhet të kalojnë një test anglishteje, sipas përcaktimit të Senatit, para se të nisnin me studimet e tyre, çka iu mundëson të bashkëpunojnë në nivelin ndërkombëtar dhe të kuptojnë publikimet kërkimore ndërkombëtare.[RVV dok 3.5.3, 3.9 & 3.9.1; M4 & 5](Kapitulli I, Standardi I.4)

3.4 Kapaciteti i universitetit për sa i përket infrastrukturës, stafi dhe financimit merret parasysh gjatë hartimit të programeve të reja.[ASCAL 3]Secili departament parashikon mësimdhënien çdo vit, sipas akteve nënligjore aktuale, dhe në fund të vitit raporton për performancën në raport me planin.[RVV dok 3.17, 3.19 & 3.19.1; M6]Mësimdhënia shitesë nga stafi i brendshëm ose i jashtëm financohet plotësisht nga universiteti.[RVV dok 3.19.2]Stafi akademik ka marrëveshje vjetore ku bie dakord për kohën e kaluar gjatë mësimdhënies, kërkimit dhe detyrave të tjera.[RVV dok 3.18; M6]Stafi bashkëngjitur instituteve kërkimore ka një ngarkesë të zvogëluar të mësimdhënies, në mënyrë që të përqendrohet te veprimtaritë kërkimore.[RVV dok 3.17.1, 3.17.2 & 3.17.2.1](Kapitulli I, Standardi I.5)

3.5 Universiteti ofron 36 programe, që synojnë të ofrojnë njohuritë bazë, parimet shkencore të përgjithshme, dhe aftësitë specifike që janë të nevojshme për punësim ose për kalimin në nivelin Master.[RVV dok 3.5.3; M3 & 4] Modulet përfshijnë lëndë formuese të përgjithshme, gjuhë të huaja, dhe studime kompjuterike, si dhe module specifike sipas lëndëve. Modulet specifike sipas lëndëve ndahen në module me detyrim dhe me zgjedhje për t'iu dhënë studentëve mundësinë të përgatiten për punësim apo studim në fushat e tyre të interesit.[RVV dok 1.2 Neni 34 & 35] Universiteti ofron mundësi për transferimin e krediteve midis programeve në të njëjtin nivel, si në universitet ashtu edhe në institucione të tjera të arsimit të lartë.[RVV dok 1.2 Neni 78 & 79, 3.20 & 3.20.2]Mesatarisht 40 për qind e të diplomuarve nga cikli Bachelor fillojnë të punojnë dhe 60 për qind vijojnë me studimet e Masterit.[RVV dok 1.18] Studentët konfirmuan se programet Bachelor i përgatitin për punësim dhe vazhdim në studimet e nivelit Master.[M3-5](Kapitulli I, Standardi I.7)

3.6 Studentët e programeve Bachelor pohojnë se universiteti ofron përvojë të mirë për t'iu mundësuar atyre të përshtaten me mjedisin e universitetit. [M3] Secili program ka emëruar një koordinator dhe studentët mbështeten përmes sistemit të tutorimit. [M3-5] Sekretaritetë e fakultetit dhe departamentit, zyrat e TI-së, punonjësit e bibliotekës dhe qendrat e karrierës ofrojnë mbështetje ditore gjatë programeve të tyre. [ASCAL 3; M3-7] Leksionet, seminarët, klasat laboratorike, projektet, vlerësimet, dhe praktika profesionale referohen në rregullore dhe sigurohen në të gjitha programet kur është e përshtatshme. [Dok RVV 1.2 neni 37, 3.31. 3.27 & 3.27.1] Metodatat alternative të mësimdhënies përfshijnë raste studimore dhe workshop-e. [Dok RVV 3.3.5 & 3.3.6] Universiteti i jep përparësi punësimit të stafit akademik me profil të mirë kërkimor, si në Shqipëri edhe jashtë vendit. [Dok RVV 1.23 f. 45 & 46] Stafi akademik i brendshëm mbulon më shumë se 70 për qind të ngarkesës mësimore në programet Bachelor. [Dok RVV 3.2 & 3.4] (Kapitulli I, Standardi I.8)

3.7 Universiteti ofron 100 programe Master, duke përfshirë 65 programe Master të Shkencës dhe 35 Master Profesional, ku mësimi zhvillohet vetëm me staf akademik që përfshinë profesorë ose doktorë, dhe që angazhohen në veprimtari kërkimore. **[RVV 1.23 f. 45 & 46]** Studentët pohuan se mësuesit e tyre kanë kualifikime dhe përvojë të madhe. **[M3-5]** Këta punonjës janë përfshirë edhe në hartimin dhe zbatimin e programeve të reja Master si pjesë e grupeve të punës. **[ASCAL 3]** Për sa iu përket programeve Master, 25-30 për qind e krediteve lidhen me projektin kërkimor ose diplomën, dhe udhëhiqen nga stafi akademi me kualifikimet e duhura. **[Dok RVV 3.21, 4.7.1 & 4.7.2]** Edhe projektet kërkimore të Masterit janë në përputhje me politikat kërkimore të universitetit, të miratuara nga Senati. **[Dok RVV 4.16 & 4.2.4]** Stazhet e studentëve zhvillohen si në organizata dhe shoqëri publike edhe në ato private, si dhe ekzistojnë mundësi për bashkëpunim në projekte kërkimore. **[Dok RVV 3.23; M4 & 10]** Qendra e Karrierës dhe departamentet mbledhin të dhëna për punësimin e studentëve dhe hartojnë një bazë të dhënash për të diplomuarit në Master. **[Dok RVV 1.42 & 3.22; M10]** Mbi 85 për qind e stafit akademik që japin mësim në programet e Masterit janë staf i brendshëm, dhe lektorë të ftuar në fusha specializimi ftohen për të folur me studentët. **[Dok RVV 3.15.3] (Kapitulli I, Standardi I.9)**

3.8 Programet e studimit janë në përputhje me ciklet pasardhëse sipas procesit të Bolonjës, dhe vlerësohen me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), dhe kreditet e fituara në universitet dhe jashtë vendit njihen në rregullore. **[Dok RVV 1.2, 3.3.1, 3.20 & 3.20.2]** Një student me kohë të plotë studion 60 kredite në vit me rreth 25 orë mësimore për kredit, të cilat përfshijnë teori dhe punë praktike. **[Dok RVV 3.3.2]** Me përfundimin e programit vihet në dispozicion suplementi i diplomës, si në gjuhën shqipe edhe në atë angleze. **[Dok RVV 3.24 & 3.24.1]** Të gjitha programet Bachelor kanë një element të gjuhës së huaj në kurrikul, ndërsa studentët e Masterit dhe doktoraturës duhet të kalojnë një provim në gjuhën angleze para se të pranohen. **[Dok RVV 3.3.7, 3.9 & 3.9.1]** Të gjithë studentët e programeve të Masterit dhe doktoraturës që u takuan me ekipin e vlerësimit të jashtëm treguan njohuri dhe nivel të lartë të gjuhës angleze. **[M4, M5]** Mobiliteti i pakët i studentëve në programet evropiane u identifikua si pikë e dobët gjatë vlerësimit të jashtëm në prill të vitit 2017, por Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohoi** se universiteti ka ndërmarrë hapa për të rritur numrin e programeve të shkëmbimit të studentëve, dhe për t'i reklamuar ato më mirë te studentët e mundshëm. Universiteti ka programe shkëmbimi me 41 universitete brenda kuadrit të programit KAI të Erasmus+, dhe 54 për qind e tyre janë të reja ose janë rinovuar gjatë periudhës 2017-2019. **[Dok RVV 1.23 f. 60-63]** Megjithëse numri i studentëve që merr pjesë në programet e mobilitetit nuk ka pasur një rritje të ndjeshme këtë vit, është e qartë se studentët kanë më shumë dijeni për to dhe numri i aplikimeve është rritur rreth dhjetëfish që prej vitit të shkuar. **[Dok RVV 3.28, 3.28.1 & 3.28.2; M2-7 & M11] (Kapitulli I, Standardi I.10)**

3.9 Integrimi i zbatimit praktik dhe njohurive teorike brenda programit të studimit arrihet përmes rasteve studimore, punës laboratorike, detyrave praktike dhe projekteve, praktikës profesionale dhe tezës përfundimtare ose projektit kërkimor. **[Dok RVV 3.25, 3.25.1, 3.25.2 & 3.25.3; M3-5]** Praktika profesionale dhe stazhet në institucionet publike ose shoqëritë private janë të detyrueshme për të gjithë studentët, kur përfshihen në planet mësimore. **[ASCAL 3; M4 & 6]** Stazhet vlejné 6-10 kredite në profilin studimor dhe mbikëqyren nga stafi akademik.

Studenti shkruan një raport dhe sistemimi në stazh vlerëson edhe performancën e studentit, të cilat përdoren gjatë vlerësimit. **[Dok RVV 1.2 neni 74-76, 3.3.1 & 3.3.2]** Për të bërë lidhjen e teorisë me praktikën përdoren edhe tezat e diplomës, rregullat për hartimin e të cilave përcaktohen në mënyrë të qartë. **[Dok RVV 3.26]** Studentët marrin pjesë në veprimtari kulturore dhe arsimore që organizohen nga universiteti, ndërsa ky i fundit siguron infrastrukturë dhe mbështetje për to. **[Dok RVV 1.23 f. 17-18] (Kapitulli I, Standardi I.11)**

3.10 Programet Bachelor dhe Master përmbajnë module që lidhen drejtpërdrejt me punësimin, dhe hartimi i programeve të Masterit Profesional është një përpjekje e drejtpërdrejtë në pajisjen e tregut të punës me të diplomuar me dije dhe njohuri ndërdisiplinore. **[Dok RVV 3.12]** Stazhet, që janë pjesë e moduleve të praktikës profesionale, janë një mënyrë e rëndësishme përmes së cilës studentët fitojnë si teorinë dhe zbatimin praktik, edhe aftësitë për punësim. **[Dok RVV 3.25]** Studentët pohuan se stazhet janë një pjesë e dobishme e programit të tyre lidhur me përgatitjen e studentëve për punësim. **[M3 & 4]** Përfaqësuesit e biznesit me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm janë aktorë të rëndësishëm të sektorit publik dhe privat në Shqipëri, dhe mbështetës të universitetit. **[M10]** Ata përfshihen në ofrimin e stazheve, vlerësimin e studentëve, këshillimin për përmbajtjen e kursit dhe hartimin e programeve të reja. **[M10]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideron lidhjet e forta dhe të gjithanshme me përfaqësuesit e sektorit publik dhe privat, që mund ta mbështesin universitetin në dobi të studentëve, si një shembull të **praktikës së mirë**. Gjithashtu, universiteti po ngre Qendrat e Karrierës për t'i nxitur më shumë këto lidhje dhe për t'i mbështetur studentët në punësim. **[M10] (Kapitulli I, Standardi I.12)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- lidhjet e forta dhe të gjithanshme me përfaqësuesit e sektorit publik dhe privat, që mund ta mbështesin universitetin në dobi të studentëve **(Kapitulli I, Standardi I.12)**.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët në Fushën e Vlerësimit.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim në Fushën e Vlerësimit.

Pohim për veprimet e ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi ndërmarrjen e veprimit të mëposhtëm:

- universiteti ka ndërmarrë hapa për të rritur numrin e programeve të shkëmbimit të studentëve, dhe për t'i reklamuar ato më mirë te studentët e mundshëm (**Kapitulli I, Standardi I.10**).

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Programet e studimit të universitetit janë përshkruar si duhet në formularë të ndryshëm. Ato janë postuar në faqen e internetit të secilit fakultet. [<http://fshs-ut.edu.al/>; <http://www.feut.edu.al/mba/emba.html>] Në shumicën e faqeve të internetit, aktualisht informacioni gjendet vetëm në gjuhën shqipe. Stafi tregoi se faqja e përditësuar e internetit do të përmbajë informacion edhe në gjuhën angleze. [M6 & 7]. Në fillim të çdo viti akademik, Senati rishikon dhe miraton planet mësimore për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësisë bazë. [RVV f. 34; Dok RVV 4.1 7 & 4.1.1; M6 & 11] secili prej gjashtë fakulteteve është përgjegjës për planifikimin e orëve mësimore të stafit dhe planin e saktë të punës për vitin akademik. [Dok RVV 4.2, 4.2.1, 4.2.2 & 4.2.3] Gjatë turit në burimet e mësimnxënies u vu re se institucioni ofron kapacitetet të mjaftueshme për studentët e tij. [Turi në burime] (Kapitulli I Standardi II.1)

4.2 Në fillim të çdo viti akademik, pas regjistrimit të studentëve, kodet dhe fjalëkalimet e studentëve gjenerohen nga Administratori i Sistemit të Informacionit, një pozicion në Rektorat, dhe këto kredenciale përdoren për të hyrë në portal dhe për të pasur akses në informacionin individual të studentit [RVV f. 34; M3 & 4] Studentët mund të këshillohen me faqet e internetit të fakulteteve për kalendarin e provimeve, kriteret e diplomimit, udhëzime mbi procedurën e vlerësimit dhe informacione të tjera lidhur me vlerësimin. Rregullat, kriteret e vlerësimit dhe specifikat e provimeve përcaktohen në programin e lëndës për secilin modul. Studentët informohen nga mbikëqyrësi akademik i modulit gjatë javës së parë të secilit semestër. [Dok RVV 3.3.1.1 & 4.10; <http://www.unitir.edu.al/>] Sistemi i regjistrave të studentëve i mundëson stafit akademik të hedhin notat e studentëve, që duhet të firmosen nga të paktën dy pedagogë, të caktuar nga Përgjegjësi i Departamentit. [RVV, f. 35] (Kapitulli I Standardi II.2)

4.3 Leksionet vlerësohen rregullisht nga departamentet dhe fakultetet, ndërsa programet e studimit i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë, të cilat angazhojnë njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë. [Dok RVV 4.12 & 4.13; AE 13.1, 13.2 & 13.3] Stafi akademik i brendshëm dhe i jashtëm vlerësohet rregullisht përmes pyetësorëve të studentëve, leksioneve të hapura, vlerësimit nga përgjegjësit e departamenteve dhe vetëvlerësimit. Fakultetet përdorin mjete të ndryshme për këtë vlerësim, por, siç theksohet në pikën 2.3, universiteti vijon punën e tij për të standardizuar proceset e vlerësimit të stafit. Programet e studimit dhe kurrikula i nënshtrohen përmirësimit të vazhdueshëm për të reflektuar ndryshimet e sugjeruara nga bizneset dhe partnerët e tjerë. Duke qenë se objektivi kryesor i universitetit është t'iu ofrojë studentëve të tij njohuri teorike dhe praktike, institucioni është dukshëm i orientuar drejt nevojës së biznesit. Përfaqësuesit e biznesit pohuan se ata janë gjithmonë pjesë e procesit të përmirësimit të kurrikulës. [M6, 7 & 10] Rezultatet e studentëve publikohen rregullisht dhe në mënyrë anonime, duke përdorur një numër identifikimi për secilin student. Studentët u shprehën se ndihen të lirë që të komunikojnë me pedagogët e tyre për çdo çështje që ka lidhje me notat e tyre. [M3 & 4] (Kapitulli I, Standardi II.3)

4.4 Universiteti ka ngritur një strukturë mbështetje të përshtatshme për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, duke përfshirë strukturat e mbështetjes, monitorimit dhe këshillimit për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies së ofruar nga Drejtoria e Programeve të Mësimdhënies, dhe Sigurimit të Cilësisë pranë Rektoratit, degë e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe qendrave të karrierës së njësisë kryesore. Këto struktura mbështesin njësitë bazë në ndjekjen e zbatimit të cilësisë së programeve të studimit dhe vlerësojnë performancën e stafit akademik dhe mbështetës. **[RVV f. 37; Dok RVV 1.35 & 4.12] (Kapitulli I Standardi II.4)**

4.5 Departamenti është njësia kryesore vendimmarrëse për mësimdhënien, mësimnxënien, vlerësimin dhe kërkimin. Departamentet, si njësia bazë mësimore dhe kërkimore, mbledhen rregullisht për të diskutuar çështje të rëndësishme lidhur me organizimin e veprimtarive kërkimore, përparësitë e veçanta kërkimore, botimet, promovimin, etj. **[Dok RVV 4.14; M6 & 11]** Bazuar në kualifikimet dhe botimet e tyre, performanca kërkimore e stafit akademik është e pranueshme. **[M6 & 11; AE 7.1.2]** Rreth 10 për qind e buxhetit të përgjithshëm të universitetit alokohet për veprimtaritë kërkimore. Megjithatë, nuk është e qartë sesi ndahet financimi ndërmjet studuesve or grupeve kërkimore, dhe stafi tregoi se kërkimi financohet kryesisht nga studues individualë, gjë që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi si **pikë të dobët**. Prandaj, **rekomandohet** që universiteti të krijojë dhe zbatojë një mekanizëm që i nxit departamentet të gjenerojnë financim për kërkimin përmes projekteve dhe veprimtarive të tjera. **[Dok RVV 2.12; M6 & 11; AE 7.1.2] (Kapitulli II Standardi I.1)**

4.6 Universiteti është pjesë e shumë projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat e ndihmojnë në zhvillimin e kërkimit. Bashkëpunimi dhe rrjetet e krijuara përmes partneriteteve kanë sjellë më shumë ndërveprim dhe komunikim shkencor ndërmjet studuesve. Megjithatë, kërkimi shumëdisiplinor ndërmjet departamenteve dhe fakulteteve do të ishte i dobishëm nisur nga një qasje më e koordinuar. **[Dok RVV 1.23, tabelat 20 & 21; Dok RVV 1.6.1 & 4.33; AE 12.1 & 12.2] (Kapitulli II Standardi I.2)**

4.7 Universiteti ka shtuar veprimtaritë e tij të ndërkombëtarizimit në vitet e fundit nëpërmjet botimeve dhe simpoziumeve ndërkombëtare, marrëveshjeve të ndryshme ku stafi akademik dhe studentët kanë qenë pjesë e përvojave mësimore ndërkombëtare, punësimit të stafit që janë diplomuar jashtë vendit, etj. **[Dok RVV 1.23, tabelat 20 & 21]** Studentët dhe stafi ofruan disa shembuj të përvojave më të fundit ndërkombëtare. **[Dok RVV 4.15, 4.15.1, 4.15.2 & 4.15.3; M 3, 4 & 6]** Fakultetet dhe departamentet organizojnë konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe stafi akademik merr pjesë në konferencat shkencore ndërkombëtare të organizuara nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. **[Dok RVV 4.22] (Kapitulli II Standardi I.3)**

4.8 Fushat prioritare për kërkimin shkencor përcaktohen në Planin Strategjik të Kërkimit Shkencor 2018-2020, i cili është miratuar nga Senati dhe tregon se universiteti ka ndërmarrë veprime për adresimin e plotë të pikës së dobët të identifikuar gjatë vizitës së Grupit të Jashtëm të Vlerësimit në prill të vitit 2017. **[Dok RVV 4.25]** Universiteti ka organizuar aktivitete shkencore lidhur me fushat prioritare. Stafi pohoi se idetë për prioritetet kërkimore janë zhvilluar në nivel

departamenti para se të dakordësoheshin nga universiteti. **[Dok RVV 4.23, M6] (Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5)**

4.9 Vazhdimësia në kërkimin shkencor mundësohet nëpërmjet përfshirjes së stafit të ri akademik dhe studentëve të doktoraturës në veprimtaritë kërkimore të departamentit. Kjo përfshin ndërthurjen e kërkimit për projekte dhe teza me projektet kërkimore për çështje të interesit institucional dhe kombëtar. Gjithashtu, përfshirja e stafit të huaj në veprimtarinë kërkimore dhe e organizatave të huaja partnere në veprimtaritë kërkimore mundëson vazhdimësinë e kërkimit shkencor. **[Dok RVV 1.23; M5]** Universiteti i nxit fakultetet dhe departamentet të ftojnë staf akademik të huaj që të marrin pjesë në veprimtaritë kërkimore dhe në leksione të hapura. **[Dok RVV 4.23]** Universiteti ndjek një politikë të favorshme për mobilitetin e stafit akademik të përfshirë në kërkimin shkencor, kryesisht përmes projekteve dhe partneriteteve. **[Dok RVV 4.15.4; M6; <http://fshs-ut.edu.al/projekte-bashkepunimi/>]** Edhe përmirësimi i kërkimit shkencor po përfiton nga procesi i ndërkombëtarizimit të studimeve. **[Dok RVV 1.28, 1.29, 1.30]** Stafi tregoi se po vijon puna për të hartuar një portofol modulesh që do zhvillohen në gjuhën angleze, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e **pohon** këtë veprim. **[M6 & 11] (Kapitulli II Standardi I.6)**

4.10 Universiteti ndjek një politikë mbështetjeje të seminareve ndërkombëtare dhe simpoziumeve shkencore. **[Dok RVV 4.23]** Në përgjithësi, fakultetet kanë burime financiare për organizimin e simpoziumeve shkencore vjetore. Pjesëmarrja e stafit akademik në konferencat shkencore jashtë vendit është i rëndësishëm. Gjithashtu, edhe studiuesit nxiten të ndajnë rezultatet e punës së tyre kërkimore në platformat virtuale **[Dok RVV 4.22, 1.23, tabelat 13-9; AE 7.1.2] (Kapitulli II Standardi I.7)**

4.11 Fakultetet dhe departamentet publikojnë në disa revista, si: Revista ‘Studime Ligjore’ **[publikuar nga Fakulteti i Drejtësisë, ISSN: 2220-3990]**; Revista e Shkencave të Natyrës’ **[publikuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ISSN: 2305-882X]**; Revista ‘Studime Shqiptare’ **[publikuar nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë]**; Revista ‘Ekonomia dhe Biznesi’ **[publikuar nga Fakulteti i Ekonomisë]** **[Dok RVV 4.27; 4.27.1; 4.27.2]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson në mënyrë periodike efektshmërinë e veprimtarive kërkimore të zhvilluara nga njësitë kryesore, në përputhje me standardet përkatëse. **[Dok RVV 1.1, neni 29/2]** Tezat e doktoraturës publikohen në faqet e internetit të fakultetit. Megjithatë, pika e dobët e identifikuar gjatë vlerësimit të jashtë në prill të vitit 2017 solli rekomandimin që universiteti të hartojë dhe zbatojë një politikë zyrtare për plagjiaturën dhe sjellje të tjera akademike të papërshtatshme. Mungesa e politikës zyrtare të universitetit për zbulimin e sjelljes akademike të papërshtatshme dhe plagjiaturës në veçanti, mbetet **pikë e dobët**. Prandaj, **rekomandohet** që universiteti të hartojë dhe zbatojë një politikë zyrtare për plagjiaturën dhe sjellje të tjera akademike të papërshtatshme si çështje prioritare. **[M5 & 6] (Kapitulli II Standardi I.8)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë në Fushën e Vlerësimit.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pikat e dobëta të mëposhtme:

- mungesën e qartësisë se si ndahet financimi ndërmjet studiuesve ose grupeve kërkimore, dhe se kërkimi financohet kryesisht nga studiues individualë (**Kapitulli II Standardi I.1**)
- mungesën e politikës zyrtare të universitetit për zbulimin e sjelljeve akademike të papërshtatshme, dhe plagjiaturën në veçanti (**Kapitulli II Standardi I.8**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti të hartojë dhe zbatojë politikën zyrtare dhe kriteret për alokimin dhe shpërndarjen e fondeve për kërkimin në nivel fakulteti dhe departamenti, si dhe një mekanizëm që i nxit departamentet të gjenerojnë financim për kërkimin nëpërmjet projekteve dhe veprimtarive të tjera. (deri më gusht 2019) (**Kapitulli II Standardi I.1**)
- universiteti të hartojë dhe zbatojë një politikë zyrtare për plagjiaturën dhe sjellje të tjera akademike të papërshtatshme si çështje prioritare. (deri më gusht 2019) (**Kapitulli II Standardi I.8**).

Pohim për veprimet e ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi ndërmarrjen e veprimit të mëposhtëm:

- universiteti po harton një portofol modulesh që do të zhvillohen në gjuhën angleze (**Kapitulli II Standardi I.6**).

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Universiteti është aktiv për sa i përket rekrutimit të studentëve në programet e ciklit të parë direkt nga shkollat e mesme shqiptare. Fakultetet organizojnë vizita rekrutimi ku stafi akademik dhe administrativ viziton shkollat dhe bëjnë prezantime të programeve të studimit që ata ofrojnë. Pranimi i studentëve të vitit të parë koordinohet edhe përmes portalit 'U-Albania'. [<https://ualbania.arsimi.gov.al/Universitet/UniversityIndex>; M11] Zëvendës Rektori për Mësimdhënien dhe zëvendës dekanët në secilin fakultet kanë përgjegjësinë e përgjithshme për procesin e regjistrimit dhe orientimit të studentëve. Zëvendës dekanët e fakultetit dhe përgjegjësit e departamentit raportojnë te zëvendës rektori për zbatimin e procesit të rekrutimit dhe orientimit për studentët e rinj. Pranimi i studentëve për secilin vit akademik kryhet në përputhje me kriteret dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara për secilin program studimit, të cilat publikohen në faqen e internetit të institucionit. [<http://www.unitir.edu.al/>; M1 & 11] Për studentët e vitit të parë Bachelor, organizohen ditët e orientimit dhe në secilin fakultet publikohet udhëzuesi i studentëve. [Dok RVV 3.2.1 & 3.2.2; M3 & 7] (Kapitulli I, Standardi III.1)

5.2 Universiteti ka struktura administrative të përshtatshme për të garantuar të drejtat e studentëve në aksesin në informacion. [Dok RVV 1.2.1 & 1.35] Institucioni ka një zyrë të Karrierës së Studentëve, e cila luan një rol kyç në asistimin e veprimtarive orientuese për studentët e rinj. [M3&] Departamentet luajnë një rol të rëndësishëm në orientimin e studentëve të rinj në programet e tyre. Gjithashtu, universiteti përdor faqen e internetit dhe tabelat e njoftimit të fakultetit dhe departamenteve për t'i pajisur studentët me informacionet që kërkojnë. I gjithë stafi akademik dhe studentët kanë adresat e tyre të emailit që ua ofron universiteti. Një mjet tjetër i rëndësishëm është portali i studentëve, i cili në periudhën e vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm ishte në ndërtim e sipër, dhe nuk ka qenë funksional për një periudhë kohore. [M3] Institucioni ka një sistem informimi të efektshëm për ruajtjen e informacioneve personale të studentëve. [Dok RVV 5.4] (Kapitulli I, Standardi III.2)

5.3 Fakultetet dhe departamentet janë përgjegjëse për procesin e mentorimit dhe tutorimit, i cili është një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës së studimit. [Dok RVV 5.5] Stafi akademik i brendshëm kanë periudha të caktuara për tutorimin e studentëve dhe ky informacion postohet në faqen e internetit. Gjithashtu, Zyra e Karrierës luan një rol vendimtar në orientimin dhe mentorimin e studentëve duke i ndihmuar gjatë studimeve të tyre, dhe nëpërmjet këshillimit për mundësitë e stazhit dhe punësimit në të ardhmen. [Dok RVV 5.6] Nga diskutimet e zhvilluara me stafin dhe studentët, u konfirmua efikasiteti i marrëveshjeve të orientimit dhe të mentorimit. [M3, 4 & 5] Studentët pohuan se iu janë dhënë të gjitha këshillat që ata kanë nevojë gjatë studimeve të tyre, dhe se kanë mundësi të kontaktojnë me stafin për këshilla individuale gjatë orëve të punës, leksioneve dhe seminareve. Nga diskutimet e zhvilluara me stafin dhe studentët, u konfirmua se marrëveshjet aktuale të orientimit dhe të mentorimit janë të kënaqshme. [M3, 4, 5 & 6] (Kapitulli I, Standardi III.3)

5.4 Universiteti siguron nivele të përshtatshme mbështetjeje për kategoritë e veçanta sociale. Politikat dhe procedurat përqendrohen kryesisht në heqjen apo reduktimin e tarifës shkollore për studentë të caktuar dhe bëhen në përputhje të plotë me kërkesat dhe pritshmëritë

e Ministrisë. Universiteti alokon afërsisht 10 për qind të kuotave të pranimit për kategoritë e veçanta sociale në ciklet e para dhe të dyta të studimeve. **[Dok RVV 3.5.1, 3.5.2 & 5.11]** Këshilli i Ministrave përcakton numrin e bursave vjetore të disponueshme. Përveç kësaj asistence financiare, studentëve të kategorive të veçanta nuk iu ofrohet asnjë mbështetëse shtesë, veçanërisht në infrastrukturë pasi nuk sigurohen rampat ose ashensorët për lehtësi të përdoruesve të karrigeve me rrota. **[Turi në burime] (Kapitulli I, Standardi III.4)**

5.5 Universiteti siguron librat përkatës shkollorë në gjuhën shqipe dhe gjuhët e huaja në të gjitha bibliotekat e tij, të cilat ndodhen pranë secilit fakultet. Koleksioni i përgjithshëm përmban 182,502 kopje, ndërsa sallat e studimit kanë një kapacitet prej 1,258 vendesh. Rrjeti i madh i skedarëve (në rend alfabetik për autorët dhe titujt, sistematik, topografik), i krijuar me kalimin e viteve dhe bibliografitë e ndryshme i ndihmojnë përdoruesit e bibliotekës të kenë lehtësisht akses në informacionin e kërkuar. **[Dok RVV 2.20 & 5.14]** Biblioteka bashkëpunon me fakultetet dhe departamentet për të siguruar që të bëhet përditësimi i fondit të librave. Gjithashtu, ofrohet edhe akses në EBSCOHOST dhe SAGE. **[Dok RVV 5.27]** Studentët janë pyetur edhe për fondin e librave. Biblioteka ofron kurse formimi për të ndihmuar studentët që të kërkojnë dhe të gjejnë informacion akademik online. Studentët janë shprehur se janë të kënaqur me faktin se tekstet janë të disponueshëm dhe kanë thënë se në rast se një tekst në format të shtypur nuk gjendet, informacione rreth tij mund të kërkohen online. **[M3, 4, 5 & 7] (Kapitulli I, Standardi III.5)**

5.6 Universiteti organizon veprimtari për mbështetjen e studentëve të ciklit të parë për të lehtësuar performancën e tyre, si leximi, kërkimi, përzgjedhja e informacionit, etj. **[Dok RVV 5.2 & 5.12]** Krahas procesit të tutorimit formal, kontakti i përditshëm pedagog-student ofron mundësi të tjera për të mbështetur dhe lehtësuar progresin e studentëve të ciklit të parë. Mentorimi i veçantë iu ofrohet studentëve të vitit të tretë të ciklit të parë, për t'i mbështetur gjatë përzgjedhjes dhe hartimit të temës së diplomës dhe për t'i këshilluar për mundësitë e punësimit në të ardhmen. **[Dok RVV 5.5]** Po ashtu, studentëve iu jepen këshilla dhe udhëzime para dhe gjatë mundësive të praktikës profesionale apo të sistemimit në praktikë, dhe ata shoqëron nga një pedagog në takimin e tyre të parë me ofruesin e praktikës. Zyra e Karrierës iu ofron studentëve këshilla dhe udhëzime para dhe gjatë mundësive të praktikës profesionale apo të sistemimit në praktikë. Ata mbështeten edhe për sa i përket mundësive të studimeve të ardhshme në programet e ciklit të dytë. **[Dok RVV 5.6; M3-5 & 7] (Kapitulli I, Standardi III.6)**

5.7 Universiteti nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e studentëve në jetën universitare. Studentët kanë Këshillin Studentor ku mund të diskutojnë për çështje të ndryshme dhe të ngrenë problematikat të cilat përfaqësuesit studentorë duhet t'ua paraqesin Këshillave të Fakultetit dhe Senatit për zgjidhje. Këshilli Studentor është një organ i pavarur, objektivi i të cilit është të nxisë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese, në strukturat e mësimdhënies, kërkimit dhe shërbimit. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senat. **[M3 & 4; AE 3.2]** Këshilli Studentor organizon veprimtari të ndryshme dhe trajton problematikat e ngritura nga studentët gjatë vitit akademik. **[Dok RVV 1.1, neni 77-80; M3 & 4]** Studentët përfshihen në mënyrë aktive në zgjedhjen e Rektorit dhe të të emëruarve të tjerë të nivelit të lartë, dhe japin kontribut për procesin e vlerësimit të cilësisë. Faqet e internetit të

fakulteteve kanë portale për studentin. Studentët janë shprehur se janë të kënaqur që iu janë kërkuar dhe marrë seriozisht mendimet, dhe që aty ku është menduar si praktike apo e arsyeshme, janë ndërmarrë veprime të efektshme. **[M3-5] (Kapitulli I, Standardi III.7)**

5.8 Universiteti mbështet dhe nxit veprimtaritë studentore kulturore, sportive dhe zbavitëse. **[Dok RVV 1.2, neni 80]** Raporti i Vetëvlerësimit nxori në pah se edhe pse universiteti mbështet jetën kulturore të studentëve, veprimtaritë e mbështetura financiarisht janë të rralla, gjë që konfirmohet edhe nga diskutimet me studentët. Studentët pohuan se do ta vlerësonin shtimin e numrit të veprimtarive sociale. **[M3 & 4]** Fakultetet e ndryshme organizojnë disa veprimtari, si për shembull debate në grup dhe procese gjyqësore të simuluar në Fakultetin e Drejtësisë (në vitin 2016 ata fituan vendin e parë në konkursin kombëtar), ndërsa Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve organizon veprimtari të parashikuara për mësimdhënien e vlerave njerëzore. **[Dok RVV 5.25 & 5.26] (Kapitulli I, Standardi III.8)**

5.9 Vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në prill të vitit 2017 identifikoi si pikë të dobët faktin se të dhënat statistikore për punësimin e të gjithë të diplomuarve nuk ishin të disponueshme. Megjithatë, gjatë vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, universiteti siguroi evidenca në formën e statistikave të punësimin të të diplomuarve për të treguar se rekomandimi ishte përmbushur. U vu re se Qendra e Karrierës po çon përpara përdorimin e këtyre të dhënave statistikore të universitetit, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **konfirmoi** hapat e ndërmarrë për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të punësimin të të diplomuarve. **[Dok RVV 5.6; Kopje fizike me të dhëna për punësimin]** Stafi konfirmoi se studentët e ciklit të parë kanë një periudhë stazhi gjatë vitit të tretë të programit të tyre. Studentët raportuan se stazhet mund të sjellin punësimin, por kjo nuk garantohet. Partnerët e jashtëm dhe bizneset konfirmuan kënaqshmërinë e tyre me marrëdhënien që ata kanë me universitetin, dhe shumica konfirmuan se ata ofrojnë stazhe për studentët, të cilat mund të rezultojnë në punësim në të ardhmen. **(Kapitulli I, Standardi III.9)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë në Fushën e Vlerësimit.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët në Fushën e Vlerësimit.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim në Fushën e Vlerësimit.

Pohimi për veprimet e ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi ndërmarrjen e veprimit të mëposhtëm:

- hapat e ndërmarrë për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për punësimin e të diplomuarve nga Qendra e Karrierës **(Kapitulli I, Standardi III.9)**.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- lidhjet e forta dhe të gjithanshme me përfaqësuesit e sektorit publik dhe privat, që mund ta mbështesin universitetin në dobi të studentëve **(Kapitulli I, Standardi I.12)**.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pikat e dobëta të mëposhtme:

- mungesën e qartësisë se si ndahet financimi ndërmjet departamenteve ose grupeve kërkimore, dhe se kërkimi financohet kryesisht nga studiues individualë **(Kapitulli II Standardi I.1)**
- mungesën e politikës zyrtare të universitetit për zbulimin e sjelljeve akademike të papërshtatshme, dhe plagjiaturën në veçanti **(Kapitulli II Standardi I.8)**.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- drejtuesit e lartë të universitetit të ndërmarrin hapa për të siguruar krijimin e mjedisit të koordinuar, bashkëpunues dhe konstruktiv, i cili mundëson zhvillimin në mënyrë profesionale dhe kolegiale të debateve dhe diskutimeve në të gjitha bordet dhe komitetet e ngritura zyrtarisht, për të lehtësuar qeverisjen dhe menaxhimin efektiv dhe efikas të universitetit në kohë. **(Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi II.3)**
- universiteti të hartojë dhe zbatojë politikën zyrtare dhe kriteret për alokimin dhe shpërndarjen e fondeve për kërkimin në nivel fakulteti dhe departamenti, si dhe një mekanizëm që i nxit departamentet të gjenerojnë financim për kërkimin nëpërmjet projekteve dhe veprimtarive të tjera(deri më gusht 2019) **(Kapitulli II Standardi I.1)**

